



R E P U B L I K A E K O S O V Ë S
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
G J Y K A T A T H E M E L O R E N Ë P R I S H T I N Ë
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRANAK LIPLJAN

P.nr. 579/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, Nexhmije Ahmeti, në lëndën juridiko-penale, kundër të pandehurës M. H. nga fsh. B. K. L., për shkak të veprës penale Shpërdorim të pasurisë së huaj nga neni 330 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, të cilën e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.nr.2019/16 të dt.26.08.2016, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me datën 09.02.2017, në prani të Prokurorit të shtetit Fatmire Cacaj, dhe të akuzuarës, në të njëjtën ditë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurës:

M. H., e lindur me dt. *data e lindjes...* në L., me vendbanim në fsh. B. K.L., nga i ati A., me numër personal *numër personal...*, shqipëtare, shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e padenuar, mbrohet në liri.

Konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së, përshkak të heqjes dore nga akuza nga ana e prokurorit,

REFUZOHET AKUZA

Me datën 25.02.2016, rreth orës 16:00, me qëllim që me përvetsimin e sendeve të huaja të luajtsëme, vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm, deri sa ishte në parkingun e automjeteve tek V.-F., e pandehura, pasi e ka vërejtur, ka arritur që ta marr telefonin e markës Iphon 5, pronë e tani të dëmtuarës V. R., me ç'rast të dëmtuarës i kishte shkaktuar dëm material.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Shpërdorim të pasurisë së huaj nga neni 330 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale për këtë çështje juridiko-penale mbeten në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

E dëmtuara V.R. nga L., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP.II.nr.2019/16 të dt.26.08.2016, ka akuzuar të pandehurën M. H., për shkak të veprës penale, Shpërdorim të pasurisë së huaj nga neni 330 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, në këtë çështje penale duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, ka mbajtur shqyrtim gjyqësor, në të cilin prokurori i shtetit, në prani të akuzuarës dhe të dëmtuarës, deklaroi se pasi që pala e dëmtua ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe vepra penale për të cililën tani ngarkohet e pandehura është vepër penale që sipas par. 7 të nenit 330 të KPRK-së, ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar dhe propozimi i palës së dëmtuar është tërhequr në shqyrtimin e sotëm dhe për këtë prokuroria heq dorë nga akuza.

Me dispoziten e nenit 363 par. 1 nën par. 1 të KPPK-së, prashifet se “Gjykata merr aktgjykim me të cilin refuzohet akuza kur prokurori i Shtetit tërhiqet nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor”.

Meqenëse në rastin konkret prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza ndaj të pandehures, për këtë arsye dhe bazuar në dispoziten e lartëcekur gjyakta e refuzoi aktakuzën ndaj të pandehures.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 454 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil u bazua në nenin 463 par. 3 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 579/2016 dt. 09.02.2017.

Procesmbajtësja
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të së njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.